



Të nderuar Prindër, Kujdestarë ose Përgjegjës ligjorë të Nxënësve të Rinj të pranuar në Shkollat e Mesme,

Edukimi Shëndetësor që mëson marrjen e vendimeve të përgjegjshme ndihmon nxënësit të jenë më produktivë në shkollë dhe në jetë. Së bashku me Edukimin Shëndetësor, Shkollat Publike të Nju Jorkut (NYC Public Schools) ofrojnë Programin e Disponueshmërisë së Prezervativëve (Condom Availability Program – CAP) në shkollat e mesme, për t'i ndihmuar nxënësit të marrin vendime të shëndetshme jashtë klasës. Përmes CAP, nxënësit e klasave 9–12 mund të kërkojnë falas prezervativë, informacion shëndetësor të saktë nga ana mjekësore dhe referime shëndetësore nga stafi i trajnuar i shkollës.

Ju keni të drejtë t'i kërkonit shkollës që të **mos** i ofrojë fëmijës tuaj prezervativë. Sipas Ligjit të Shëndetit Publik § 2504 (Public Health Law § 2504), ju nuk mund ta bëni këtë kërkesë nëse fëmija juaj: 1) është 18 vjeç ose më i madh; 2) është ose ka qenë i martuar; 3) është prind, dhe/ose 4) lejohet nga ligji të japë pëlqimin për veten.

Për të kërkuar që fëmija juaj të **mos** marrë prezervativë përmes Programit CAP, duhet të më shkruani një letër që përfshin:

- Emrin e plotë të nxënësit
- Klasën e nxënësit
- Numrin e identifikimit të nxënësit (Shënim: Nëse nuk e keni këtë informacion, ne do t'jua japim)
- Deklaratën e mëposhtme: “[Full name of student] nuk duhet të marrë prezervativë përmes Programit të Disponueshmërisë së Prezervativëve (Condom Availability Program).”
- Nënshkrimin tuaj si prind, kujdestar ose përgjegjës ligjor

Nëse ndryshoni mendim dhe vendosni që fëmija juaj mund të kërkojë prezervativë falas, mund të më dërgoni një letër në çdo kohë gjatë vitit shkollor. Stafi i trajnuar në CAP është i përkushtuar të mbajë konfidenciale pjesëmarrjen e çdo nxënësi në program.

Ne ju inkurajojmë të flisni me fëmijën tuaj për shëndetin seksual dhe tema të tjera shëndetësore në shtëpi, për t'i ndihmuar ata të marrin vendime pozitive për shëndetin. Faleminderit që bashkëpunoni me ne për t'i ndihmuar nxënësit e Nju Jorkut të ndihen të sigurt, të shëndetshëm dhe të aftë për të lulëzuar.

Me respekt,

Drejtori/Drejtoresha